



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 7, datë 25.03.2025

PËR
MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E KËSHILLIT DREJTUES
NR. 16 DATË 30.04.2020 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KARTËN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM
NË AGJENCINË E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE””

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52, pika 1, shkronjat “dh” dhe “j” dhe të nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 17, pika 1 dhe të nenit 18, pika 1 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 18 pika 2 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm

V E N D O S I:

1. Në rregulloren “Për kartën e auditimit të brendshëm në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 16, datë 30.04.2020, në nenin 5, pika 1 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“1. Audituesi i Brendshëm i Agjencisë, përzgjidhet nëpërmjet procedurave të kontraktimit në përputhje me kriteret për për zgjedhjen, të miratuara nga Këshilli Drejtues.”





2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi nga strukturat përkatëse të Agjencisë.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

